

## STATUT I SHOQËRISË “TRAFALGAR”shpk

Sot, me datë 27.01.2021, Ortak themelues:

**Smerald Bozaxhiu**, shtetas i Republikës Shqiptare, lindur me 12.03.1989, ne Tirane, dhe banues ne Tirane, i pajisur me pashaporte me nr. Personal I90312062G madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,

**Dorian Boja**, shtetas i Republikës Shqiptare, lindur me 25.04.1989, ne Tirane, dhe banues ne Tirane, i pajisur me pashaporte me nr. Personal I90425061U madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,

Vendosen miratimin e ketij Statuti me termat e meposhtem:

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria Tregtare “ **TRAFALGAR** ”shpk rregullon poziten e saj juridike, marredheniet e themeluesve, te organeve te saj, llojin e Shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, marredheniet me te punesuarit, duke u bazuar ne ligjin nr. 9901, te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojne marredheniet e Shoqerive Tregtare, si dhe kete Statut.

#### Neni 1

Shoqeria gezon te drejta si person juridik, qe prej dates ne te cilen kryhet regjistrimi i saj ne Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

#### Neni 2

Forma e Shoqerise

Shoqeria do te kete formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.

Kjo shoqeri do te perballoje humbjet e saj deri ne vleren e kapitalit themeltar te saj te paraqitur ne kete Statut.



### **Neni 3**

Emerimi Tregtar

Emri Tregtar i Shoqerise eshte "TRAFALGAR" shpk

### **Neni 4**

**Selia**

Shoqëria e ka selinë në adresë TIRANE Njësia Administrative Nr. 5. Rruga "Pjetër Bogdani", Godina 18, Hyrja 1, Apartamenti 1, Nr. Pasurisë 2/150+1-1, Zona Kadastrale 8270

Shoqëria me vendim te Asamblese se Ortakeve, mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 5**

#### **Objekti i Veprimtarisë**

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise do te jete:

1. Veprimtari tregtare ne fushen e ushqimit social, bar-bufe, restaurante, hoteleri dhe aktivitet turistik. Tregetim te artikujve te ndiyshem te konsumit te gjere, industrial e ushqimioire, lende te para, materiale, paisje dhe makineri te llojeve te ndiyshme e pjese kembimi per to, me shumice e pakice, me importe dhe eksporte Import-eksport dhe tregetim te mjeteve te transportit (automjete, motociklete, biciklete, etj.), pjese kembimi e materiale konsumiper to, te reja e teperdorura. Veprimtari ne transporte te llojeve te ndryshme te mallrave e udhetareve, me tranzitime ne porte e pika kufitare te Shqiperise. Grumbullim, perpunim dhe tregetim te produkteve bujaesore, blegtorale, bime medicinale e prodhime te pyllit. Konsulence tregtare e marketingu, sherbime te tjera te ngjashme. Kryerjen e transaksioneve te ndryshme te importeve dhe eksporteve te mallrave, objekt i 2 veprimtarise se shoqerise, qe hyjne ne Shqiperi, prekin kufirin e saj shtetedor ose nuk prekin fare ate. Operacione tregtare ne komisioneri. Veprimtari industriale me materiale te porositesit. Prodhim e tregtim te materialeve te ndryshme qe nevoiten per ndertimin dhe kompletimin e objektve ndertimore. Si dhe cdo veprimtari tjetër, qe veçmas ose sebashku me ato te permendura me siper do te konsiderohet e pershtatshme dhe me leverdi per rritjen e zhvillimin e shoqerise tregtare.

Objekti i shoqerise mund te plotesohet e modifikohet ne cdo kohe me miratimin ne perputhje me ligjet perkatese. Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekt te ngjashem me te.

**Neni 6**  
**Kohëzgjatja e shoqerise**

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj per nje afat kohor 5- vjecar, Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardolloj shkak. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit te Shoqerise ne Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

**Neni 7**  
**Kapitali**

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100.000 ( njëqind mijë) leke, i zotëruar si me poshte:

Nr.	Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
1	<b>Smerald Bozaxhiu</b>	50%	1
2	<b>Dorian Boja</b>	50%	1


Ky kapital i perket aksionerve te shoqerise, 50% **Smerald Bozaxhiu** dhe 50% **Dorian Boja**. Kuotat e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, pasi te jete marre miratimi i ortakëve te tjere te shoqerise, duke respektuar te drejten e parablerjes, kur transferimi behet me ane te shitjes.

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet por jo nen vleren nominale 100.000 leke

**Neni 8**

**DREJTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj **Smerald Bozaxhiu**, ortak i Shoqerise dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i shoqerise ne mardhenjie me te tretet dhe ka kopetenca te plota ne drejtimin e saj. Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga perfaqesues i paisur me prokure te posacme



## Neni 9

### VENDIMARRJA E SHOQERISE

Te gjithë te nenshkruarit deklarojne se do te zbatojne te drejten e parablerjes mbi transferimin e kuotave, duke e parashikuar si despozite specifike ne statutin e Shoqerise, despozite e cila do ndaloje transferimin e kuotave tek pale te treta pa miratimin e te gjithë ortakeve te Shoqerise, si dhe do te detyroje secilin ortak qe deshiron te transferoje kuotat e tij per ti ofruar ato per blerje tek ortaket egzistues.

Pro-rata me perqindjet e tyre ne kapital dhe sipas nje vlere ne perputhje me inventarin e investimeve bashkelidhur dhe parimet e zbatueshme te kontabilitetit

Ortaket deklarojne se do te ndryshojne statutin e Shoqerise duke shtuar detyrimin e unanimitetit te te gjithë ortakeve te shoqerise ne rastin e vendimarrjeve per nenshkrimin e kontratave te qirase te Shoqerise, kredimarrje ne banke ose institucione financiare te ndryshme, aktet per perfshirjen e shoqerise si garantor ne kredimarrje dhe vendime te ngjashme te rendesishme si keto.

## Neni 10

**Te ardhurat neto te shoqerise do te ndahen midis ortakeve sipas kapitalit, 50% Smerald Bozaxhiu dhe 50% Dorian Boja**

## Neni 11

### Kompetencat e Asamblesë


Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Të përcaktojë politikat tregtare të shoqërisë;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me eksperte të caktuar prej tij;
- Të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Të vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Të ushtrojë të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## Neni 12

### Administrimi i shoqërisë

Ortaket kane te drejte te emeroje nje administrator, financiere, likujdator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake



**Neni 13**  
**Viti financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

**Neni 14**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 15**  
**Të ndryshme**


Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky Statut vlejné dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, pjesa e parë mbi “Dispozitat e Përgjithshme”, pjesa e katërt për “shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar” si dhe aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

Statuti u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t’u administruar në bazë të ligjit, një kopje për tu dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe dykopje mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES

“TRAFALGAR”shpk

**Smerald Bozaxh**



**Dorian Boja**

